



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:071283

Datë: 12.06.2019

Numri i dokumentit: 00353930

**P. nr. 892/18**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës – dëmtuarës Q. S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga 188/1--1.4 si dhe të akuzuarës –dëmtuarës K. S. dhe veprës penale sulm nga neni 187/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP.nr.1648/18 e datës 11.12.2018,në shqyrtimin fillestar , të mbajtur më datë **11.06.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Dëshire Jusaj dhe të akuzuarave- dëmtuarave Q. S. dhe K. S. ,të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

E akuzuara **K. S.**, nga Gjakova,, Rr”... ”p. n. , data e lindjes ... ,në ... të Malit të Zi , e bija e M. dhe e L. e gjinisë K.i, ka të kryer 3 kl. të shkollës fillore , amvise , e gjendjes së dobët ekonomike , në bashkësi jashtë martesore -nënë fëmijë , rome ,shtetas i R. Kosovës, me ID ...

E akuzuara **Q. S.** nga Gjakova,, Rr”A.I. ”p. n. , data e lindjes ... ,Gjakovë , e bija e M. dhe e F. e gjinisë H. , ka të kryer shkollën fillore , amvise , e gjendjes së dobët ekonomike , e martuar , nene e 3 fëmijëve , rome ,shtetas i R. Kosovës, me ID ...

### Ë s h t ë f a j t o r e :

**E akuzuara Q. S.**

**Sepse:**

**I.**

**-me dt. 23.10.2018**, rreth orës **16:20** min, në rrugën “ A. I. “ i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarës –te akuzuarës K.S. nga Gjakova, Rr”... ” ,në atë mënyrë që derisa e dëmtuara K. S. ishte duke biseduar me të akuzuarën Q. rreth djegies së shtëpisë së saj dhe shprehet me fjalët “Kush ma ka kall shtëpinë ishalla evladi i kallet në djep si shtëpia ime “ ,e pas këtyre fjalëve reagon e akuzuara Q. ku rrahën në mes veti dhe e akuzuara Q. merr një copëz druri e me të e godet një here në kokë të dëmtuarës –akuzuarës K. e nga goditjet i shkakton lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko –ligjore të dr. V. H.i dt. 06.12.2018.

**-me çka ka kryer vepër penale lëndim i lehtë truporë nga neni 188 par.1-1.4te KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,41,49,50,51,73 të KPRK-ës, nenit 188 par.1-1.4 dhe nenit 187/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarës Q.S. i shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre ) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara- akuzuara K. S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të mjeteve të gjykatës .

**E akuzuara K. S.**

### **Ë shtë fajtore**

**Sepse**  
**II**

-me datë , kohë dhe vend si në dispozitivin e I-re të aktakuzës, e përdor forcën fizike pa pëlqimin e të dëmtuarës – akuzuarës Q.S. ,në atë mënyrë që gjatë rrahjes e sulmon fizikisht të akuzuarën Q. duke e tërhequr zvarrë për flokë, pa i shkaktuar lëndime të dukshme trupore .

**-me çka ka krye veprën penale sulm nga neni 187/1 të KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës, nenit 188 par.1-1.4 dhe nenit 187/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarës K. S. i shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4 (katër ) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara- akuzuara Q.S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të mjeteve të gjykatës .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1648/18 të dt.19.12.2018, i ka akuzuar të akuzuarat Q. S., për shkak të veprës penale. penale lëndim i lehtë trupor nga 188/1 të KPRK-së si dhe të akuzuarën K.S. nga Gjakova veprës penale sulmi nga neni 187/1 të KPRK-së,

Gjatë shqyrtimit fillestar, me të datës 11.06.2019, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Dëshire Jusaj lexon aktakuzën PP.nr. 1648/18 dt. 19.12.2018, deklaroi se mbetet në tersi pranë aktakuzës, por shtojë se beje precizimin e kualifikimit juridik të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor me dëmtim të përkohshme ashtu që duhet të jete me çka ka kryer veprën penale nga neni 188/1-1.4 të KPRK-ës, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

E akuzuara Q.S. , gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për rastin se ka ndodhur ,mirëpo deri të vepra e kryer nga ana e ime ka ardhur pas reagimit gjegjësisht sulmit që me është bere nga ana e këtu të dëmtuarës – akuzuarës K.S. , i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur në gjykatë , premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla edhe në të ardhmë do të jem me i kujdesshëm edhe pse nga e njëjta vazhdimisht kam kërcënime si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

E akuzuara K.S. , gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për rastin se ka ndodhur , i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur në gjykatë , gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë prokurori i shtetit Dëshire Jusaj , deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që të njëjtat janë të vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara Q. S. :**I. me dt. 23.10.2016**, rreth orës **16:20** min, në rrugën “ . . . “ i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarës –te akuzuarës K. S.nga Gjakova, Rr” . . . .” ,në atë mënyrë që derisa e dëmtuara K.S. ishte duke biseduar me të akuzuarën Q. rreth djegies se shtëpisë se saj dhe shprehet me fjalët “Kush ma ka kall shtëpinë ishalla evladi i kallet në djep si shtëpia ime “ ,e pas këtyre fjalëve reagon e akuzuara Q. ku rrahën në mes veti dhe e akuzuara Q. merr një copëz druri e me të e godet një here në kokë të dëmtuarës –akuzuarës K., e nga goditjet i shkakton lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko –ligjore të dr. V. H.të dt. 06.12.2018.,dhe e akuzuara K.S. se : **II-me datë** , kohë dhe vend si në dispozitivin e I-re të aktakuzës, e përdor forcën fizike pa pëlqimin e të dëmtuarës – akuzuarës Q.S. ,në atë mënyrë që gjatë rrahjes e sulmon fizikisht të akuzuarën Q. duke e tërhequr zvarrë për flokë, pa i shkakuar lëndime të dukshme trupore .

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarat të cilat në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë ,për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarat është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se të akuzuarat kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga të akuzuarat , pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarave formohen të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitivat të këtij

aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarat të shpallen fajtores dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarave, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të veprave penale të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve se janë nena të fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga të akuzuarat pendimin e tyre, premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, gjendjen e dobët ekonomike-shfrytëzuese të ndihmave sociale, si dhe faktin se të njëjtat me parë nuk kanë qene të dënuar nga ana e gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se të akuzuarën –dëmtuarën Q.S. e dënon me dënimin burgim në kohëzgjatja prej **3(tre) muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarat brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, si dhe të akuzuarën-dëmtuarën K. S. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarat, dhe se ky sanksion do të ndikoj tek të akuzuarat që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri në mbështetje të nenit 453/4 të KPP-ës, pasi që të akuzuarat janë të shfrytëzues të ndihmave sociale e detyrimi që të paguajnë shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarave ose të personave që ai detyrohen të mbështesin materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.892/18 më datë 11.06.2019**

**Sekretarja juridike**

**Gjyqtarja**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.